



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 2082/ Prot

Tiranë, më 12/05/2025

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Gjykatës Kushtetuese
Blv. Dëshmorët e Kombit, nr. 26, 1001 Tiranë

Për dijeni: Presidentit të Republikës
Blv. Dëshmorët e Kombit, nr. 1, 1001, Tiranë
Kuvendit të Shqipërisë
Blv. Dëshmorët e Kombit, nr. 4, 1001, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj të datës 15.04.2025 drejtuar Gjykatës së Lartë për njoftimin e kalimit të çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, parashtrojmë si vijon:

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në datën 11.04.2025, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak, ka kaluar për gjykim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me kërkesë: Presidenti i Republikës, me objekt: "Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.". Referuar kërkesës që na keni vënë në dispozicion, Presidenti i Republikës, bazuar në vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese (GJK), e cila deklaroi mbarimin e mandatit të kryetarit të saj, ka kërkuar që të deklarohet mbarimi i mandatit të gjyqtarit, pasuesi i të cilit duhet të emërohet nga Presidenti.

Referuar vendimit të GJK që ka pranuar se, "në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së Gjykatës, ky i fundit prevalon", Presidenti i Republikës konkludon se "GJK duhet të kishte përfunduar procedurën për deklarimin e mandatit të gjyqtarës Sonila Bejtja dhe të kishte njoftuar Presidentin e Republikës për vakancën përpara datës 25.01.2025 (pika 3 e nenit 9 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e GJK të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar)". Sipas tij, "kjo gjë jo vetëm nuk ka ndodhur, por edhe nuk ka asnjë njoftim publik nga ana e GJK në këtë drejtim."

Pra, organi i emërtesës që duhet të plotësojë vakancën e krijuar nga gjyqtari, mandati i të cilit duhej të ishte deklaruar i mbaruar nga GJK deri në datën 25.04.2025, kërkon nga kjo e fundit

të veprojë, me qëllim që të aktivizohet procesi i emërimit nga Presidenti i Republikës, ashtu siç u veprua në rastin e dy vakancave të mëparshme, procesi i të cilave ka filluar tashmë, konkretisht nga Kuvendi dhe Gjykata e Lartë.

Meqenëse kolegji me tre gjyqtarë i GJK e ka konsideruar të nevojshme shprehjen e qëndrimit të Gjykatës së Lartë për këtë çështje, pavarësisht rezervës lidhur me pozicionin procedural në të, po parashtrijmë konsideratat e Gjykatës së Lartë për disa aspekte, që i takojnë, natyrës së gjykimit, shqyrtimit paraprak nga kolegji, si dhe themelit të çështjes, duke besuar se do t'i shërbejnë gjykimit që po zhvillohet para asaj Gjykate.

1. Mbi natyrën e gjykimit

Është e pamundur të shmanget habia se për çështjen me objekt të përcaktuar qartë në kërkesën e Presidentit të Republikës për “*Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të GJK*”, kolegji me tre gjyqtarë i asaj Gjykate, në fazën e shqyrtimit paraprak, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazën e dokumenteve për kryerjen e një gjykimi të zakonshëm dhe me palë kundërshtare, e njohur ndryshe si gjykim *kontroversial*.

Duke iu rikthyer kujtesës jurisprudenciale, për herë të parë në historinë 33 vjeçare nga krijimi i GJK në Shqipëri, një gjykim i tillë i natyrës deklarative, i nënshtrohet një procesi gjykimi me palë kundërshtare dhe, për më tepër, me thirrjen e organeve kushtetuese si palë kundërshtare në një çështje të konsideruar si “*mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve*”, kur dihet qartë se vendimi për deklarimin e mbarimit të mandatit nuk lidhet as formalisht dhe as substancialisht me një shkak të tillë kushtetues. Është fakt i njohur botërisht, në të gjitha vendet që kanë një GJK, se deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit është një vendimarrje e detyrueshme për GJK, në një proces pa palë kundërshtare, në përfundim të të cilit jepet një vendim deklarativ, që shërben për të njohur formalisht datën e përfundimit të mandatit të gjyqtarit dhe nisjen e procedurës për zgjedhjen/emërimin e gjyqtarit pasues.

Arsyeja, që ky gjykim dhe vendimi që nxirret ka natyrë deklarative, lidhet me faktin se nuk nevojitet kryerja e një hetimi të thelluar gjyqësor dhe kërkimi i ndonjë dokumentacioni, që nuk e ka të administruar GJK, ashtu siç nuk kërkohet paraqitje e parashtrimeve nga organet kushtetuese, dëgjimi i ndonjë pale a subjekti të interesuar, apo kryerja e një debati gjyqësor. Kjo sepse është vetë GJK, që e inicion dhe e përfundon këtë proces, pa u varur nga subjekte të tjera kushtetuese. Në këtë gjykim, nuk ka palë ndërgjyqëse, madje edhe në rastin e fundit, kur GJK me vendimin nr. 84, datë 23.12.2024, deklaroi mbarimin e mandatit të kryetarit të saj (megjithëse tej afatit ligjor), nuk e trajtoi atë si një gjykim me palë, por ashtu si në të vërtetë është: *deklarativ*!

Për shkak të natyrës që ka gjykimi deklarativ, Kushtetuta nuk ka parashikuar as subjekte inicuese dhe as ndonjë procedurë të hollësishme, duke ia besuar fillimin dhe përfundimin e këtij procesi vetë GJK, e cila, në funksion të ruajtjes së legjitimitetit institucional dhe si autoriteti që interpreton në mënyrë përfundimtare Kushtetutën, nuk mund të pengohet të ushtrojë kompetencën e saj qoftë edhe nga kryetari i asaj Gjykate, duke mos ushtruar kompetencën ligjore për nisjen e këtij procesi. Përderisa Kushtetuta ka sanksionuar momentin e fillimit dhe të mbarimit të mandatit

të gjyqtarit kushtetues, si dhe përtëritjen një herë në tre vjet, të 1/3 së përbërjes së saj, është detyrim i GJK për të përmbushur në kohë këtë parashikim.

Këtë linjë arsyetimi e gjejmë edhe në vendimin nr. 84, datë 23.12.2024, kur GJK ka pranuar se çdo vonesë për vënien në lëvizje të GJK "(pg.15)... për vendimmarrjen e saj nuk mund të përbëjë pengesë dhe as shkak për të mos ushtruar apo për të shuar kompetencën e Gjykatës për deklarimin e mbarimit të mandatit të një gjyqtari të saj, për sa kohë mandati dhe kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë përbëjnë garanci për pavarësinë dhe legjitimitetin e gjyqtarit dhe, për rrjedhojë, edhe të vetë Gjykatës.". Ky qëndrim i mbajtur dëshmon për standardin e vendosur nga GJK se procedurën për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit nuk mund ta pengojë askush, as kryetari i Gjykatës dhe as ndonjë organ tjetër kushtetues. Ky është edhe thelbi i kësaj vendimmarrjeje të rëndësishme të GJK.

Megjithatë, në përpjekje për të shmangur mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet organit të emërtesës dhe vetë GJK, në rastin kur kryetari i GJK, për çfardo lloj arsyeje, nuk fillon procesin për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit, ajo ka ofruar një mekanizëm, që më tepër duket se krijon konflikti, se sa e zgjidh atë. Në këtë vendim, GJK ka pranuar se "në çdo rast kur një organ i emërtesës vlerëson se Gjykata nuk e ka ushtruar kompetencën e saj brenda afatit ligjor, ai duhet t'i drejtohet Gjykatës, duke i kërkuar me shkrim ushtrimin e një kompetence të tillë, si dhe duke parashtruar, në çdo rast, edhe argumentet përkatëse në drejtim të fakteve dhe dispozitave kushtetuese në të cilat mbështet qëndrimin e tij për mbarimin e mandatit të gjyqtarit për pozicionin e të cilit është organ emërtese sipas Kushtetutës dhe ligjit".

Nëpërmjet këtij qëndrimi të mbajtur, GJK i ka hapur rrugën disa interpretimeve:

- (i) Kryetari i GJK, ose edhe vetë trupa e plotë e saj mund të mos veprojnë në kohë për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit;
- (ii) Organi i emërtesës duhet të ndërpresë ushtrimin e kompetencës së vet, derisa GJK të shprehet; Në të kundërt ai duhet t'i drejtohet GJK me kërkesë, për t'i kujtuar interpretuesit përfundimtar të Kushtetutës se ka përfunduar mandati i gjyqtarit;
- (iii) Nëse nuk do të vihet në lëvizje GJK, atëherë standardi kushtetues i deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarit dhe i përtëritjes së përbërjes së saj, do të mbetej i pazbatuar në afatet kushtetuese!

Qëndrimi i mbajtur në këtë vendim lidhet me rastin, kur për shkak të mosveprimit të kryetarit të GJK, organi i emërtesës, që ndjehet i cenuar në ushtrimin e kompetencës së vet, i kërkon GJK nisjen e gjykimit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit. Ndërkohë, në Kushtetutë dhe në ligjin organik, organet e emërtesës së gjyqtarëve të GJK (Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë) nuk kanë asnjë raport institucional me GJK gjatë procedurës për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues.

Nga një qëndrim i tillë jurisprudencial, natyrshëm lind pyetja: Në rastet kur, as kryetari i GJK edhe as organi emërtesë (për arsye të ndryshme), nuk inicojnë gjykimin për deklarimin e mbarimit të mandatit, çfarë duhet të bëjë GJK? A duhet të qëndrojë në pritje të paraqitjes së kërkesës për tu vënë në lëvizje?!

Në fakt, pyetje të tilla nuk mund të shtrohen për një Gjykatë Kushtetuese. Performanca e një Gjykate Kushtetuese varet shumë nga ata që veshin mantelin e gjyqtarit, të cilët duhet të bëhen mbrojtësit kurajozë dhe energjik të parimeve kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut.¹ Deklarimi i mbarimit të mandatit të një gjyqtari kushtetues është çështje e legjitimitetit dhe e përgjegjshmërisë së GJK që nuk varet nga opinioni personal i gjyqtarit. Natyra e një gjykimi deklarativ nuk lidhet dhe as kushtëzohet nga “subjektivizmi” apo nga “qenia në konflikt interesi”, që mund të ketë apo që mund të shfaqë gjyqtari i GJK në deklarimin ose jo të mbarimit të mandatit të tij. Me zgjedhjen në atë funksion të rëndësishëm, gjyqtari i GJK ka prezumimin e njeriut parimor, të emancipuar, të përgjegjshëm, me integritet të lartë dhe të spikatur profesionalisht, cilësi që garantojnë misionin e vërtetë të institucionit, që realizon drejtësinë kushtetuese. Si person me këto cilësi të larta dhe për shkak të njohurive specifike që ka, si një njohës i spikatur i Kushtetutës, gjyqtari kushtetues, që në momentin e zgjedhjes, ka të gjithë kapacitetin intelektual e profesional, por edhe jurisprudencial për të kuptuar dhe për të pranuar me ndërgjegje të plotë se kur i fillon dhe kur i përfundon mandati.²

Referuar vendimit nr. 84, datë 23.12.2024, në të cilin është konfirmuar se “për vendimmarrjen e saj nuk mund të përbëjë pengesë dhe as shkak për të mos ushtruar apo për të shuar kompetencën e Gjykatës për deklarimin e mbarimit të mandatit të një gjyqtari të saj”, konkludohet se GJK duhet të veprojë nëpërmjet trupës gjyqësore, që vendos në shumicën e saj. GJK nuk mund të pengohet nga askush dhe as mund të presë të ushtrojë kompetencën e saj e varur nga organet emërtesë. Ky është një proces që shërben për të filluar plotësimin e vakancës nga organi i emërtesës, pa bërë ndonjë vlerësim në meritë. Për më tepër që ky nuk është një proces *adversial*, që GJK të vlerësojë nëse duhet të deklarojë apo jo mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues. Në mënyrë të veçantë vetë GJK (ashtu si dhe 3 organet e emërtesës) e di mirë se kur u përfundon mandati i gjyqtarëve të saj dhe se cila nga vakancat duhet të plotësohet.

Për rrjedhojë, në raste të tilla, deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet kryesisht (*ex officio*), nëpërmjet nismës së vetë gjyqtarëve kushtetues, me qëllim që GJK të mos pengohet për të “ushtruar kompetencën për deklarimin e mbarimit të mandatit të një gjyqtari të saj, për sa kohë mandati dhe kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë përbëjnë garanci për pavarësinë dhe legjitimitetin e gjyqtarit dhe, për rrjedhojë, edhe të vetë Gjykatës”.³ Ky është misioni i këtij autoriteti kushtetues, i cili nuk lejon në asnjë rrethanë dhe për çfarëdo lloj arsyeje të nëpërkëmbet në ushtrimin e kompetencave të ngarkuara nga Kushtetuta.

Zgjidhja e ofruar nga GJK, në rastin konkret, për paraqitjen e kërkesës nga organi i emërtesës duket jo relevante për zgjidhjen e krizës kushtetuese, sepse ka shërbyer për zvarritjen në mënyrë të panevojshme, tej parashikimeve kushtetuese, të procesit të plotësimit të vakancave dhe përtëritjes së përbërjes së saj. Kjo duket se ka detyruar Presidentin e Republikës, që pasi

¹ Herman Schwartz, “The New East European Constitutional Court”, Michigan Journal of International Law (1992), 744.

² Këtë qëndrim ka mbajtur edhe GJK në vendimin nr. 84, datë 23.12.2024; Konkretisht: “(pg.19)... Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandatit të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandatit, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016; nr. 24, datë 09.06.2011 të GJK).”

³ Shih paragrafin 15 të vendimit nr. 84, datë 23.12.2024 të GJK.

vlerësoi se Gjykata nuk e ka ushtruar kompetencën e saj brenda afatit ligjor, t'i bëjë kërkesë GJK, më datë 30.01.2025 (5 ditë pas skadimit të afatit), me objekt "Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të GJK", me bindjen se "Gjykata, pa vonesë, duhet të shprehet me vendim, i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim".⁴

2. Për formimin e drejtë të ndërgjyqësisë në procesin kushtetues

Presidenti i Republikës ka synuar të zbatojë me përpikmëri atë që ka thënë GJK në vendimin për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj. Sipas Presidentit të Republikës: "nëse është e vërtetë se, në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së Gjykatës, ky i fundit prevalon, atëherë GJK duhet të kishte përfunduar procedurën për deklarimin e mandatit të gjyqtarës Bejtja dhe të kishte njoftuar Presidentin e Republikës për vakancën përpara datës 25.01.2025 (pika 3 e nenit 9 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e GJK të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"). Kjo gjë jo vetëm nuk ka ndodhur, por edhe nuk ka asnjë njoftim publik nga ana e GJK në këtë drejtim." Pra, Presidenti i Republikës është detyruar t'i kërkojë me shkrim GJK të ushtrojë kompetencën e saj, duke parashtruar edhe argumentet përkatëse në drejtim të fakteve dhe dispozitave kushtetuese, në të cilat mbështet qëndrimin e tij për mbarimin e mandatit të gjyqtarës Sonila Bejtja, pasardhësi i së cilës duhet të emërohet prej tij, sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Fakti që në kërkesën e Presidentit të Republikës është cituar si bazë ligjore neni 131 shkronja "ç" e Kushtetutës dhe neni 54, pika 3 i ligjit organik të GJK, përbën vetëm anën formale dhe jo atë substanciale për nisjen e këtij gjykimi. Paraqitja e kërkesës në këtë formë është imponuar nga GJK, e cila ndonëse nuk ka bërë referencë në Kushtetutë apo në ligj, i kërkon organit të emërtesës paraqitjen e një kërkesë të tillë. Vetë Presidenti i Republikës, si organ emërtese nuk evidenton ndonjë mosmarrëveshje kompetence me Kuvendin apo me Gjykatën e Lartë. Ai i bën thirrje GJK të mbyajë qëndrim dhe të deklarojë, referuar vendimmarrjes së saj, mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues në vitin 2025, si detyrim për kryerjen e përtëritjes së parë të GJK, pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016.

Nëse Presidenti i Republikës, për të zgjidhur çështjen sipas objektit, ka vendosur formalisht në kërkesë dy organet e emërtesës, Kuvendin dhe Gjykatën e Lartë, por pa evidentuar asnjë mosmarrëveshje me to, kjo nuk është arsye thelbësore që kolegji i GJK ta shndërrojë atë në një proces *adversial*, me palë kundërshtare. Për Gjykatën e Lartë është tepër e qartë se arsyeja që Presidenti i Republikës i është drejtuar GJK për të deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtarit nuk vjen as nga padija, as nga paqartësia se cilit gjyqtar i mbaron mandati. Vetë arsyetimi i përdorur nga GJK në vendimin e saj nr. 84, datë 23.12.2024 ka zgjidhur kushtetutshmërisht dy çështje: a) përparësinë që ka respektimi dhe zbatimi i parashikimit kushtetues të përtëritjes së përbërjes, në raport me parimin e vazhdimësisë së mandatit, b) vitin 2025, si viti i kryerjes së përtëritjes në një të tretën e gjyqtarëve të saj. Kërkesa e Presidentit ka qenë e imponuar nga fakti se kryetari i GJK

⁴ Paragrafi 19 i vendimit nr. 84, datë 23.12.2024 të GJK.

nuk ka vepruar 3 muaj para përfundimit të mandatit të gjyqtarit, sjellje e përsëritur kjo edhe për vakancën që duhet të plotësohet nga GJK.

Pavarësisht dispozitës që është cituar në kërkesën e paraqitur nga Presidenti i Republikës, referuar ligjit organik të GJK dhe të gjitha parimeve procedurale të njohura botërisht, formimi i rregullt i ndërgjyqësisë është detyrim i gjykatës. Përderisa është GJK, e cila ndodhet para detyrimit të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të saj, me të drejtë lind pyetja: *Cila është arsyeja që kolegji i GJK thërret si subjekte të interesuara dy organet e tjera të emërtesës, kur të dy ato kanë shpallur tashmë vakancat dhe presin të zgjedhin/emërojnë gjyqtarin pasardhës për secilin nga vakancat që u takon? Cili është konflikti mes Kuvendit, Gjykatës së Lartë dhe Presidentit të Republikës, kur secili prej tyre ka nga një vakancë dhe ndërkohë Presidenti nuk ka paraqitur asnjë pretendim se është ndaluar të ushtrojë kompetencën e tij prej Kuvendit ose Gjykatës së Lartë, por në fakt po pengohet prej vetë GJK, që nuk deklaron mbarimin e mandatit të gjyqtarit të saj, megjithëse afati ligjor ka kaluar tashmë?*

Edhe në parashtrimin që bëhet në kërkesën e paraqitur nga Presidenti rezulton se Gjykata e Lartë e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të plotësuar vakancën, pavarësisht se edhe në atë rast GJK nuk veproi brenda afatit kushteutes për të deklaruar mbarimin e mandatit. Këtë e ka pranuar edhe vetë GJK në vendimin nr. 84, datë 23.12.2024.

Në vijim të qëndrimit të shprehur më lart, mendojmë se thirrja e subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe e Gjykatës së Lartë, në një proces për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të GJK, nuk është zgjidhja e duhur. Thirrja e Gjykatës së Lartë në këtë proces, duke mos pasur asnjë pikëprerje me kompetencën e Presidentit, duket më së paku si padituri për proceset e posaçme të gjyqimit kushtetues dhe më së shumti si qëllim për ta kanalizuar procesin në një konflikt të paqenë kompetence!

3. Për shqyrtimin paraprak nga Kolegji

Kolegji i GJK, para se të vendoste shqyrtimin e çështjes dhe paraqitjen e saj trupës së plotë të GJK si një “mosmarrëveshje kompetence” me Kuvendin dhe Gjykatën e Lartë, duhej të kishte proceduar duke i kërkuar:

- kryetarit të GJK zbatimin e Kushtetutës dhe nisjen e procesit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit, që pritet të zëvendësohet nga Presidenti i Republikës,

ose në të kundërt

- të gjithë gjyqtarëve të GJK ushtrimin e kompetencës kushtetuese të Gjykatës “(pg.15)... për deklarimin e mbarimit të mandatit të një gjyqtari të saj, për sa kohë mandati dhe kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë përbëjnë garanci për pavarësinë dhe legjitimitetin e gjyqtarit dhe, për rrjedhojë, edhe të vetë Gjykatës”⁵,

⁵ Shih vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 të GJK.

duke i dhënë fund në këtë mënyrë krizës kushtetuese, si dhe delegjitimitetit të vetë GJK për shkak të mospërtëritjes së një të tretës së përbërjes së saj, në vitin 2025.

Kolegji me tre gjyqtarë i GJK, duke mos e vlerësuar rëndësinë që paraqet kërkesa e Presidentit të Republikës (që në fakt është detyrim), për t'u shprehur sa më parë për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit, si dhe duke mos respektuar as vendimin e vetë GJK, e cila ka pranuar se këto çështje ka detyrimin t'i shqyrtojë "pa vonesë", rezulton të ketë kryer shqyrtimin paraprak të kësaj kërkesë, në datën 11.04.2025, pra, në kufijtë e plotësimit të afatit 3 muaj (neni 47 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000).

Nisur nga sa më lart:

- Trajtimi nga kolegji me tre gjyqtarë i kërkesës së Presidentit të Republikës me objekt "Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të GJK", si një gjykim me palë kundërshtare, (*gjykim adversial*),
- thirrja e Gjykatës së Lartë me cilësinë e subjektit të interesuar, në një gjykim që nuk ka as mosmarrëveshje kompetence dhe as palë në konflikt,
- mosvënia në lëvizje për afro 3 muaj e kërkesës së Presidentit të Republikës, që lidhet me deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues dhe kalimi i saj në seancë gjyqësore, mbi bazë të dokumenteve, për të shqyrtuar çështjen edhe mbi parashtrimet me shkrim të palëve,

krijojnë kushtet e përshtatshme për të arritur në përfundimin se kolegji me tre gjyqtarë i GJK ka krijuar një situatë të paprecedentë për jurisprudencën kushtetuese. Sidoqoftë, është në autoritetin dhe kompetencën e trupës së plotë të GJK për ta korrigjuar këtë proces, duke e zgjidhur çështjen menjëherë dhe përfundimisht, në zbatim të jurisprudencës kushtetuese dhe të vendimit nr. 84, datë 23.12.2024.

4. Për themelin

Sa i takon themelit të çështjes, që është tërësisht i qartë për Gjykatën e Lartë, por mesa duket jo për kolegjin e GJK, përforcohet qëndrimi i mbajtur dhe i deklaruar publikisht në *Njoftimin për hapjen e procedurës së aplikimit për anëtar të GJK*, datë 11.12.2024, pas kalimit të afatit 3 muaj për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të GJK se:

Neni 125, pika 6 i Kushtetutës parashikon se GJK përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj. Përtëritja e përbërjes së GJK është një proces kushtetues, ku përfshihen tre organe emërtese, Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, që zgjedhin çdo tre vjet, përkatësisht, nga një anëtar të kësaj gjykate. Për të garantuar përtëritjen e rregullt të GJK, ky proces është i detyrueshëm për t'u kryer në kohë nga tre organet e emërtesës, me qëllim shmangien e çdo krize a tensioni, që mund të cenojë legjitimitetin dhe funksionimin normal të vetë Gjykatës, si autoriteti më i lartë, që interpreton në mënyrë përfundimtare Kushtetutën.

Për shkak të rëndësisë që ka përtëritja në mënyrë të rregullt e të vazhdueshme e përbërjes së GJK, në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 ligjvënësi kushtetues i kushtoi një vëmendje

të veçantë realizimit në kohë të procesit, duke parashikuar që disa anëtarë të GJK të mos zgjidheshin me mandat të plotë. Për këtë arsye, në nenin 179 të Kushtetutës u sanksionua një skemë e qartë për përtëritjen kalimtare, sipas të cilës kufizohej mandati 9 vjeçar i gjyqtarëve që do të zëvendësonin dy gjyqtarë, mandati i të cilëve do të përfundonte në vitin 2017 dhe 2020, ndërkohë që mandati i shtatë gjyqtarëve të tjerë kushtetues përfundonte rregullisht në vitet e përtëritjes, sipas radhës, dy gjyqtarë në vitin 2016, dy gjyqtarë në vitin 2019 dhe tre gjyqtarë në vitin 2022. Nëpërmjet vendosjes së mekanizmit të kufizimit të mandatit të dy gjyqtarëve që do të pasonin ata që nuk ishin zgjedhur në vitin e rregullt të kryerjes së përtëritjes, ndërkohë që për shtatë gjyqtarët e tjerë përcaktohej viti i përfundimit të mandatit 9 vjeçar, realizohej rregullisht përtëritja e GJK në çdo tre vjet e një të tretës së anëtarëve të saj. Një zgjidhje e tillë konfirmoi përtëritjen e GJK si një detyrim kushtetues që prevalon ndaj kohëzgjatjes 9 vjeçare të mandatit të gjyqtarit. Ky standard kushtetues është qartësuar edhe në nenin 86, pika 4 të ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e GJK", ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, ku përcaktohet kryerja e përtëritjes për fazën kalimtare (deri në vitin 2022), ndërkohë që pas kësaj periudhe, çdo tre vjet (viti 2025, 2028, 2031 e në vijim) përtëritja kthehet në normalitet. Sipas nenit 9 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e GJK", ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, "Kryetari i GJK, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një gjyqtari të GJK... njofton organin e emërtesës për vendin vakant.". Rregullimi kushtetues që përcakton mënyrën e mbarimit të mandatit (neni 127, pika 2), si edhe dispozita ligjore e sipërcituar që parashikon detyrimin e GJK për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit, imponojnë gjithashtu kryerjen e procedurës për emërimin e gjyqtarit të ri, jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i GJK që ka deklaruar mbarimin e mandatit. Këto afate kushtetuese dhe ligjore nuk mund të shmangen nga asnjë organ kushtetues, aq më pak nga GJK... mosvënia në lëvizje e GJK nga kryetari i saj për të shpallur, jo më vonë se data 10.12.2024, mbarimin e mandatit të znj. Holta Zaçaj, nuk mund të pengojë dhe as të shmangë ushtrimin nga Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të kompetencës kushtetuese për zgjedhjes e anëtarit të ri të GJK...njoftimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të GJK nga kryetari i saj është një akt formal, që shërben për të shpallur një vakancë, të përcaktuar qartësisht në të gjithë procedurën e ndjekur nga Gjykata e Lartë, si organ emërtese dhe nuk sjell asnjë pasojë në vlefshmërinë e procedurës që zhvillohet për këtë qëllim...mospërmbyshja e detyrimit ligjor nga kryetari i Gjykatës së Lartë për të hapur procedurat për pranimin e aplikimit për kandidaturat për anëtarë të GJK do të pengonte Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për fillimin e procedurës së verifikimit dhe renditjes së kandidatëve, si dhe në veçanti Gjykatën e Lartë për ushtrimin e pushtetit të saj kushtetues për të plotësuar vakancën e radhës në GJK."

Qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Lartë u konfirmua edhe nga GJK në vendimin nr. 84/2024, në të cilin u sanksionua, në kuadër të parimit të luajalitetit kushtetues, "nevoja e krijimit të një modeli qeverisjeje ku mekanizmat veprojnë në mënyrë eficiente", dhe ku organet kushtetuese me "detyrimin për sjellje koherente dhe jokontradiktore... nuk duhet të kenë qëndrime zvarritëse,

bllokuese, të paqarta ose të pajustificuara". Nga ana tjetër, thelbësor në këtë vendim mbetet konkluzioni i arritur se "në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së Gjykatës, [ligjvënësi kushtetues] i ka kushtuar vëmendje të veçantë këtij të fundit."

Referuar qëndrimit të mbajtur në vendimin e sipërcituar, mosveprimi në kohë i GJK për të deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtarit, emërtesë e Presidentit të Republikës, që duhej të ishte kryer para datës 25.04.2025, nuk rezulton të ketë ndonjë justifikim, aq më pak kushtetues. Në rastin konkret, duke qenë se 2 vakancat që duhen plotësuar nga Kuvendi dhe Gjykata e Lartë janë në proces, atëherë është e vetëkuptueshme dhe mjaft e qartë se cila është vakanca e tretë, që duhet të plotësohet nga Presidenti, duke realizuar përtëritjen me një të tretën e përbërjes së GJK, çdo tre vjet.

Në përfundim:

Në vijim të qëndrimit të shprehur më lart, vlerësohet se komunikimi që i është bërë për këtë çështje Gjykatës së Lartë, nisur nga vendimi i kolegjit, si dhe trajtimi i saj si një mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve, është i papërligjur. Duke e kaluar çështjen për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, si një mosmarrëveshje kompetence dhe me palë kundërshtare, ky proces gjyqësor synohet të deformohet proceduralisht.

Pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga kolegji i GJK për këtë çështje, për të cilin Gjykata e Lartë shpreh rezervën e saj,

- në respekt të Kushtetutës, të jurisprudencës së GJK dhe të standardit të vendosur prej saj në vendimin nr. 84, datë 23.12.2024, për kryerjen e përtëritjes së një të tretës së gjyqtarëve kushtetues, në vitin 2025,
- me qëllim vijimin nga Presidenti i Republikës të procedurës për plotësimin e vakancës, që i përket për zgjedhjen e gjyqtarit të GJK,
- me synim shmangien e çdo krize, që delegjitime autoritetin e GJK dhe pengon organet emërtesë në ushtrimin e pushtetit të tyre kushtetues,

është në përgjegjësinë kushtetuese të trupës së plotë të Gjykatës Kushtetuese për tu shprehur "*pa vonesë, me vendim përfundimtar dhe të detyrueshëm për zbatim*", për kërkesën e paraqitur nga Presidenti i Republikës.

KRYETARI
SOKOL SADUSHI

